



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 27 / 03 / 2023

VENDIM
Nr.9, datë 27 /03 /2023

PËR

**MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR 2022 PËR GJËNDJEN, SHFRYTËZIMIN,
MONITORIMIN DHE SIGURINË E DIGAVE DHE DAMBAVE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave", Kreu II, Neni 4 si dhe të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Për Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM),

VENDOSI:

- 1- Miratimin e Raportit Vjetor të vitit 2022 për Gjëndjen, shfrytëzimin, monitorimin dhe sigurinë e Digave të Mëdha dhe Dambave së bashku me shtojcat përkatëse bashkëlidhur këtij Vendimi.
- 2- T'ju kërkojë zyrtarisht të gjithë shfrytëzuesve të digave dhe dambave të cilët nuk kanë dorëzuar Raportin Vjetor të shfrytëzimit të digave për vitin 2022 që të marrin masat e duhura për hartimin dhe dorëzimin e raportit vjetor të shfrytëzimit të digave që kanë në administrim në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këto raporte duhet të dorëzohen pranë KKDM brenda datës 15 Maj 2023.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për dërgimin e këtij Raporti pranë Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe ndjekjen e detyrave dhe rekomandimeve të dhëna në këtë vendim dhe në raportin vjetor të KKDM për shfrytëzuesit e digave si dhe institucionet përkatëse që administrojnë digat e mëdha dhe dambat.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

